



Dr. Ledina Mandija
Lektore, Fakulteti Juridik,
Universiteti i Tiranës/
Avokate

INTERVISTË
Arbitrazhi
Nga pikpamja e konsulentit ligjor

Cila është përvoja juaj me arbitrazhin vendas dhe ndërkombëtar?

Unë kam qenë pedagoge e procedurës civile që prej vitit 1996, në Fakultetin e Drejtësisë dhe, si e tillë, arbitrazhi ka qenë pjesë e disiplinës sime të ligjërimit. Gjithashtu, kam kryer studime të thelluara për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja dhe arbitrazhin ndërkombëtar. Në këtë kontekst, kam kryer studime doktrinare dhe kam ndjekur raste praktike të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet arbitrazhit, si vendase, ashtu dhe ndërkombëtare. Nga Prilli 2007 deri në Shkurt 2014, kam pasur detyrën e Avokatit të Shtetit duke përfaqësuar Republikën e Shqipërisë përpara Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe, në këtë cilësi, megjithëse isha përfaqësuese në Arbitrazhin Ndërkombëtar, kam ofruar këshilla ligjore për autoritetet shtetërore në lidhje me konsultimin për kontratat dhe zgjidhjen përkatëse të mosmarrëveshjeve. Nga janari 2010 deri në tetor 2013, kam pasur detyrën e Avokatit të Përgjithshëm dhe, në të njëjtën kohë, kam përfaqësuar Republikën e Shqipërisë përpara Arbitrazhit Ndërkombëtar, duke këshilluar për kontratat ndërkombëtare në fazën e hartimit dhe zbatimit.

Aktualisht, vazhdoj të jap leksione mbi arbitrazhin ndërkombëtar në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës dhe kam dhënë mendime ligjore për procedurat e arbitrazhit, si dhe për konsultimin e kontratave ndërkombëtare të cilat kanë klauzolë ndërkombëtare arbitrazhi, brenda dhe jashtë vendit.

Kur mbanit pozicionin e Avokatit të Shtetit, ju keni qenë pjesë e ekipit të përfaqësuesve ligjore që përfaqësonte shtetin shqiptar. Cilët do të përkufizonit si hapat e parë që duhen ndërmarrë nga këndvështrimi i një përfaqësuesi ligjor?

Po, kam qenë konsulente ligjore ose bashkë-konsulente në çështje. Në pozicionin e Avokatit të Shtetit, unë, personalisht, kam përfaqësuar Republikën e Shqipërisë si përfaqësuese ligjore në disa raste, ndërsa në disa raste të tjera, kam qenë bashkë-përfaqësuese, së bashku me avokatë të huaj të kontraktuar nga Republika e Shqipërisë.

Si konsulente ligjore në një çështje të arbitrazhit, mund të them se hapi i parë është ndërtimi i një strategjie me një ekip të mirë që do të punojë për çështjen. Hapi tjetër është zgjedhja e arbitrit. Më tej, unë do të thosha që është mbledhja e të gjitha provave që do të paraqiten gjatë procesit, duke përgatitur dëshmitarët dhe ekspertët faktikë.



Hartimi i saktë i termave të referencës, si dhe i rregullave procedurale të zbatueshme për procesin e arbitrazhit ka rëndësi parësore në fazën e parë të procesit të arbitrazhit.

Cila është faza juaj e preferuar kur bëhet fjalë për të punuar në një çështje arbitrazhi?

Për mua, faza më e preferuar në një çështje të arbitrazhit është seanca dëgjimore.

A ekziston ndonjë rast i veçantë, për të cilin keni punuar, të cilin mundeni ta dalloni?

Ka disa raste që bien në sy, pavarësisht nga rezultati, në arbitrazhin tregtar apo të investimeve. Mund të përmend çështjen Pantekniki kundër Republika e Shqipërisë, Sky Petroleum kundër Republika e Shqipërisë, të cilat ishin raste që lidheshin me arbitrazhin e investimeve, por edhe raste të tjera në arbitrazhin tregtar, të tilla si General Electric kundër Republika e Shqipërisë ose S. Saranda kundër Republika e Shqipërisë.

Vlen të përmendet, gjithashtu, puna e bërë nga ekipi për menaxhimin e konfliktit me kompaninë CEZ, përkatësisht, për revokimin e licencës dhe, më pas, për përgatitjen e pretendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar për kontratën e privatizimit me CEZ-in.

A ka përparësi për një klient përvoja akademike në praktikën e avokatit?

Për një klient, është zgjedhje e mirë që një praktikues i ligjit të jetë njëkohësisht akademik në fushën e arbitrazhit. Është e kuptueshme që një akademik që ka njohuri të doktrinës së arbitrazhit dhe, gjithashtu, ka udhëhequr dhe përfaqësuar çështje në praktikë është një zgjedhje shumë e mirë për klientin.

Nëse do të zgjidhnit një ose dy avantazhe të arbitrazhit institucional, cilin do të përmendnit?

Një arbitrazh institucional siguron menaxhim të mirë të çështjes, duke përfshirë një afat kohor të arsyeshëm për gjykimin e çështjes, Rregullat Procedurale të vendosura paraprakisht dhe të bëra publike për palët që i kanë pranuar ato më parë.

Në arbitrazhin ndërkombëtar, por edhe në arbitrazhin e brendshëm, ekziston një hendek gjinor në lidhje me emërimin si arbitër ose këshillues midis grave dhe burrave. Pse mendoni se ndodh kjo? Çfarë duhet të bëhet për të rritur rolin e grave në arbitrazh?

Është e vërtetë që në botën e arbitrazhit burrat janë më të përfshirë se gratë, si në rolin e arbitrit, ashtu dhe në atë të konsulentit. Kjo ndodh për shkak se arbitrazhi kërkon shumë punë dhe angazhim, duke u konsideruar si çështje serioze për sa kohë që vlerat e mosmarrëveshjeve janë të larta.

Konsiderohet se kjo lloj pune është më e përshtatshme për burrat, të cilët janë punëtorë dhe marrin përgjegjësinë për të udhëhequr ose vendosur për çështje të vështira. Sidoqoftë, ky është supozim. *Ka shumë raste kur gratë kanë vepruar me shumë sukses si këshilltare*

në çështje apo si arbitra në procese të tilla. Është i nevojshëm promovimi i grave si arbitra dhe konsulente në procedurat e arbitrazhit vendas ose ndërkombëtar.

Unë mendoj se institucionet e arbitrazhit duhet të aplikojnë kuotat gjinore në listat e arbitrave, në mënyrë që t'u japin grave mundësinë të caktohen si arbitra.

Si konsulente, mendoj se ato mund të promovohen duke u dhënë mundësi për prezantime në forume, mbledhje pune, seminare, konferenca, etj., ose duke i përfshirë në grupe pune për hartimin e ligjeve, strategjive, rregulloreve/rregullave të arbitrazhit.

Mohim: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë intervistë janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e ICC Albania-s. I gjithë informacioni i postuar është thjesht për qëllime arsimore dhe informuese.

Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze.